**PRISHTINA INTERNATIONAL FAIR**

International Fair of Construction, Energy, Technical and Wood Industry
**"EXPOKOS 2011" May 18-21, Prishtina**

# Tenth anniversary edition

# 10th EXPOKOS

# POST SHOW REPORT



## Summary

The tenth anniversary edition of the International Fair of Construction, Energy, Technical and Furniture EXPOKOS 2011 was held during May 18-21 in Prishtina. This edition clearly showed that during a decade of its functioning and growth, EXPOKOS has transformed into a promoter which serves not only as a supply market but also as a place where ideas are generated, reflection on changes, suitability of products and services with the development trends and demands of the market.

High participation of exhibiting companies from the region, European Union countries and further, frequenting the fair by thousands of visitors from Kosovo, the region, Europe and Asia, as well as many different activities organized during the fair have made EXPOKOS one of the main fairs in the region.
The success of the tenth anniversary edition of EXPOKOS besides the organizational aspect it also proves that Kosovo is ever more being looked at as a promising environment for new investments by international companies.

EXPOKOS is rightfully being qualified as a fair where the number of professional visitors and decision-making factors is very high, which is also influencing the achievement of high results by the exhibiting companies.

Parallel activities such as: B2B meetings, presentations and conferences with prominent participants from areas of construction, energy, technical and furniture are attracting the attention of all participants from these areas, media and the broader public.

During the opening speech Kosovo Assembly Speaker Mr. Jakup Krasniqi encouraged all of the business community and institutions of the country to work towards improving the investment climate in the country.



**EXPOKOS 2011**

Besides the high number of individual exhibiting companies, EXPOKOS 2011 was also attended by national pavilions from Croatia, Slovenia, Turkey, Greece, Serbia, and Bosnia and Herzegovina supported by the Investment Promotion Agencies and Economic Chambers of the respective countries.

EXPOKOS 2011 was also attended by the Italian Commission on Trade. They had B2B meetings between Italian and Kosovar Businesses. The Ambassador of Italy in Kosovo Mr. Giffoni also participated; he committed his unreserved support towards further consolidation of economic cooperation between Kosovo and Italy.

Investment Promotion Agency of Kosovo IPAK, also participated in the fair where they gave out information to the exhibiting companies about the investment climate in Kosovo.

During the fair there were a lot of presentations and B2B meetings between businesses from Kosovo and those from Greece, Croatia, Italy, etc.

**Kosovo Assembly Speaker Mr. Jakup Krasniqi during the opening ceremony**



## Data on the EXPOKOS 2011

- Official opening: May 18, 2011, 12:00
- Venue: Pallati i Rinisë, Prishtina
- Number of exhibitors: 364
- Origin of exhibitors: Kosova, Albania, Slovenia, Croatia, Turkey, Germany, France, USA, Macedonia, Serbia, Greece, Montenegro, United Kingdom, Austria, Switzerland, Bulgaria, Italy, Belgium, Netherlands, Bosnia and Herzegovina, Czech Republic, Hungary.
- National pavilions from: Slovenia, Croatia, Turkey, Greece, Serbia, Bosnia and Herzegovina
- Total number of visitors: 33 070
- Number of professional visitors: 17 372
- Number of public visitors: 15 698
- Visitor's profile: Specialists of construction, energy, machinery, wood industry, employers, distributors, managers of public and private companies, institutional leaders, students, etc.
- May 19, Gala evening, celebrating the tenth anniversary of EXPOKOS
- May 21, giving out certificates for the exhibitors

## EXPOKOS IN MEDIA

The fair was followed by main media of the country and the region, such as:
Radio and TV stations:
RTK, RTV21, KTV, FAN TV, TV Klan Kosova, Radio Kosova, Radio Dukagjini, Radio Blue Sky, Radio 21, Radio Plus, Radio Besa, etc.

Daily newspapers and Magazines:
Koha Ditore, Kosova Sot, Bota Sot, Infopress, Gazeta Express, Lajm, Zëri, Epoka e Re, EuroXtrade etc.
News Agencies and Information portals:
Kosova Press, Telegrafi, Kosova Info, Indeksonline, Kosova Live, Agjencia Ekonomia, Kosovanews, Kosova Info, Infosot, Kosova Haber, TRT Albanian, Ekonomisti, Info Globi, Kozani Media, Poslovni Dnevnik, Lajme shqip, Kosova In, Shtypi i Dites, Paragrafi,  etj.

## Supported by:

IPAK

OEDSH

EURO XTRADE

Biznesi Kosovar
Adresa ku bashkohen të gjitha Bizneset Kosovare

BE IN KOSOVO.com

# Pictures from EXPOKOS 2011





















# Media for EXPOKOS 2011

## HAPET EDICIONI JUBILAR I "EXPOKOS"

**Të mërkurën, në Prishtinë është hapur edicioni i dhjetë i Panairit ndërkombëtar të ndërtimtarisë, energjetikës, teknikës dhe industrisë së drurit "Expokos 2011". Në këtë panair po marrin pjesë mbi 360 kompani nga vendi dhe rajoni. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, i cili ka bërë edhe hapjen e këtij panairi, ka kërkuar nga të gjithë ekspozuesit që të rritet bashkëpunimi edhe më shumë mes kompanive vendore dhe atyre të huaja**



Fatos SHALA

**Prishtinë** - Në organizim të "CEO-Congress & Event Organization", të mërkurën është hapur edicioni i dhjetë i Panairit ndërkombëtar të ndërtimtarisë, energjetikës, teknikës dhe industrisë së drurit "Expokos 2011", në të cilin po marrin pjesë mbi 360 kompani nga vendi dhe rajoni. Ky panair shënon edicionin e dhjetë jubilar të tij me rritje të konsiderueshme dhe suksese të vazhdueshme që ka shënuar për një dekadë të tërë. Pjesëmarrja e ekspozuesve është vlerësuar edhe nga zyrtarët e institucioneve. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, i cili ka bërë edhe hapjen e këtij panairi, ka kërkuar nga të gjithë ekspozuesit që të rritet bashkëpunimi edhe më shumë mes kompanive vendore dhe atyre të huaja.

"Sigurisht që për mua, për të gjithë qytetarët e Kosovës, e veçanërisht për institucionet e këtij vendi, çdo sukses është i mirëseardhur dhe dëshirojmë që vërtet të hapin perspektiva të reja për prodhuesit vendorë, po ashtu të hapim perspektiva të reja për një bashkëpunim me të gjitha vendet mike, që panairet tjera pozicionin e Kosovës ta gjenin çdo herë e më të avancuar", ka thënë kryeparlamentari Krasniqi.

Edhe drejtori i organizatës CEO, Bekim Xhafa, theksoi se edicioni i sivjetshëm, i dhjeti me radhë, karakterizohet me risi të shumta. "Gjatë katër ditëve në vijim, do të ketë takime biznesi ndërmjet Kosovës dhe Italisë, pastaj me ata të Greqisë etj.", ka thënë Xhafa.

Në panairin "Expokos 2011", përveç prezantimit individual të dhjetëra kompanive, në të po marrin pjesë firma të njohura nga Sllovenia, të cilat mbështeten nga Agjencia për promovimin e eksportit, kompani nga Kroacia të organizuara nga Oda Ekonomike e Kroacisë, pavijoni i kompanive nga Turqia, të mbështetura nga qeveria turke, pavijoni i kompanive nga Bosnja, kompani nga Greqia bashkë me Odën Ekonomike të Kozanit, kompani prodhuese nga Kosova të mbështetura nga USAID-i, pavijoni i kompanive nga Lugina e Preshevës, të mbështetura po ashtu nga USAID-i etj.

Ndryshe, në Kosovë panairet organizohen në hapësira jo të përshtatshme. Ndërkohë, në zonën industriale në Fushë-Kosovë, ka nisur ndërtimi i një objekti ekskluziv për organizimin e panaireve, që do të kushtojë rreth 4 milionë euro, të siguruara nga Buxheti i Kosovës. Ky projekt pritet të përfundojë gjatë vitit 2011.

### Numri i ekspozuesve ndër vite

Numri i ekspozuesve gjatë vitit 2008 ishte 145, prej tyre 54 për qind ekspozues vendorë dhe 46 për qind ndërkombëtarë. Në vitin 2009 numri i ekspozuesve ishte 260, prej tyre 52 për qind vendorë dhe 48 për qind ndërkombëtarë. Në vitin 2010, ishin 350 prej tyre 42 për qind vendorë dhe 58 për qind ndërkombëtarë. Ndërkaq, këtë vit llogaritet që janë mbi 360 ekspozues nga 20 shtete të ndryshme.

## Mbyllet EXPOKOS-i

Prishtinë, 21 maj – Të shtunën është mbyllur edicioni i dhjetë i panairit EXPOKOS. Gjatë këtyre katër ditëve, ishte në qendër të vëmendjes së të gjithë komunitetit të biznesit, ekspertëve të fushave të ndërtimtarisë, energjetikës, teknikës dhe industrisë së përpunimit të drurit, si dhe opinionit publik. Gjatë kësaj kohe u zhvilluan takime të rëndësishme në mes të bizneseve nga Kosova me ato nga Greqia, të organizuara nga Oda Ekonomike e Kozanit. Po ashtu, takime të rëndësishme ishin edhe ato në mes të bizneseve nga Kosova me ato italiane në organizim të Komisionit Italian për Tregti dhe Agjencisë për Promovimin e Investimeve në Kosovë, me mbështetjen e ambasadorit italian në Kosovë, Giffoni, i cili gjatë takimit shprehu përgëzimet e tij për suksesin e panairit EXPOKOS dhe inkurajoi investitorët italianë për t'u involvuar më fuqishëm në tregun kosovar. Pjesë e EXPOKOS-it 2011 ishin institucione dhe asociacione të rëndësishme si: Agjencia për Promovimin e Investimeve APIK, odat ekonomike nga Kroacia, Gjermania, Greqia, Agjencia Sllovene për Investime, USAID-i, Shoqata e Arkitektëve të Kosovës, Komisioni Italian për Tregti, etj. Panairi pati frekuentim të lartë të vizitorëve jo vetëm nga Kosova, por edhe nga vendet e rajonit dhe ato nga Bashkimi Evropian.

# Media for EXPOKOS 2011




*Mbyllet panairi "Expokos 2011"*

## Frekuentim i lartë nga vizitorët

Gjatë katër ditëve sa ka qenë i hapur për vizitorë panairi për ndërtimtari, energjetikë, teknikë dhe industri e drurit "Expokos 2011" ka rezultuar të jetë i suksesshëm, vlerësojnë organizatorët dhe ekspozuesit. Panairi "Expokos 2011" gjatë këtyre ditëve ishte në qendër të vëmendjes të komunitetit të biznesit, ekspertëve të fushave të ndërtimtarisë, energjetikës, teknikës dhe industrisë së përpunimit të drurit. Njëri ndër organizatorët e panairit, Lulzim Krasniqi nga CEO, konsideron të suksesshëm këtë panair, pasi ka arritur të mbledhë shumë kompani nga vendet të ndryshme të regjionit dhe më gjerë. Ai thotë se për shumë kompani panairi ka rezultuar të jetë i dobishëm, pasi janë realizuar marrëveshje të ndryshme. "Ekspokos' në këtë vit të tij, të dhjetin jubilar, ka shënuar një ngritje jashtëzakonisht të madhe si nga numri i kompanive ekspozuese dhe aspekti i arritjes së efekteve të prezantimit të kompanive që vijnë në panair. Për këto vite ky panair ka shënuar rezultate në ndërkombëtarizimin e tij si një ngjarje e rëndësishme komerciale, i cili e ka futur edhe Prishtinën në agjendën ekonomike ndërkombëtare, gjegjësisht në pjesën e industrisë së panaireve", ka thënë Krasniqi. Serioziteti i organizimit ka bërë që në këtë panair të jenë pjesëmarrës 360 kompani të ndryshme. Njëra ndër to ishte edhe kompania "Front" nga Prishtina. Jeton Veseli, drejtor i kësaj kompanie, thotë se pjesëmarrja në këtë panair ka rezultuar të jetë e suksesshme, pasi ka arritur marrëveshje të rëndësishme. "Besoj që e kemi arritur qëllimin me këto katër ditë të pjesëmarrjes sonë në këtë panair, ku një numër i madh i vizitorëve qoftë në fushën teknike, inxhinierike, arkitekturës apo edhe investitorë të ndërtimit kanë mundur t'i shohin produktet dhe shërbimet tona që ne i ofrojmë për tregun e Kosovës", ka thënë Veseli. Panairi pati frekuentim të lartë të vizitorëve jo vetëm nga Kosova, por edhe nga vendet e rajonit dhe ato nga Bashkimi Evropian.

K.P.

## Hapet panairi "Expo-Kos"



Prishtinë, 18 maj - Dhjetëra kompani nga vendi dhe nga rajoni kanë ekspozuar të mërkurën produktet e tyre në panairin "Expo-Kos", në Pallatin e Rinisë dhe të Sporteve në Prishtinë. Panairi i cili tashmë ka mbushur dhjetë vjet, ka mbledhur përveç kompanive vendëse edhe kompani nga Turqia, Greqia, Kroacia, Sllovenia, Italia dhe Bosnjë-Hercegovina, të cilat kanë ekspozuar produktet e tyre në fushën e elektroteknologjisë dhe të ndërtimtarisë. Panairi do të jetë i hapur deri më 21 maj. *V.M.*

## HAPET EDICIONI JUBILAR I "EXPOKOS"



Të mërkurën, në Prishtinë është hapur edicioni i dhjetë i Panairit ndërkombëtar të ndërtimtarisë, energjetikës, teknikës dhe industrisë së drurit "Expokos 2011". Në këtë panair po marrin pjesë mbi 360 kompani nga vendi dhe rajoni. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, i cili ka bërë edhe hapjen e këtij panairi, ka kërkuar nga të gjithë ekspozuesit që të rritet bashkëpunimi edhe më shumë mes kompanive vendore dhe atyre të huaja

Faqe 8

# Media for EXPOKOS 2011

## Ekonomi

### Organizohet "EXPOKOS 2011"

Prishtinë - Nga data 18 deri më 21 maj, në Pallatin e Rinisë në Prishtinë do të mbahet panairi ndërkombëtar i specializuar në fushën e ndërtimit, energjetikës, teknikës dhe industrisë së drurit ?EXPOKOS 2011?.

Panairi "EXPOKOS 2011" shënon edicionin e dhjetë jubilar, me rritje të konsiderueshme dhe suksese të vazhdueshme për një dekadë të tërë.

Organizatori i panairit "CEO-Congress & Event Organization" njofton se edicioni i sivjetshëm do të karakterizohet me risi të shumta. Numri i kompanive ekspozuese do të jetë më i lartë se asnjëherë më parë. Pjesëmarrës me produktet dhe shërbimet e tyre do të jenë kompani nga Kosova, rajoni dhe nga vendet e Bashkimit Evropian e më gjerë.

Në panairin "EXPOKOS 2011", përveç prezantimit individual të qindra kompanive, do të marrin pjesë emra të njohur të firmave nga Sllovenia, të cilët mbështeten nga Agjencia për promovimin e eksportit, kompani nga Kroacia, të organizuara nga Oda Ekonomike e Kroacisë, pavijoni i kompanive nga Turqia, të mbështetura nga Qeveria turke, pavijoni i kompanive nga Bosnja, kompani nga Greqia bashkë me Odën Ekonomike të Kozanit, kompani prodhuese nga Kosova, të mbështetura nga USAID-i, pavijoni i kompanive nga Lugina e Preshevës, të mbështetura po ashtu nga USAID-i etj. Pjesëmarrës me stendat e tyre do të jenë edhe Agjencia për Promovimin e Investimeve të Huaja në Kosovë (APIK) dhe Komisioni Italian i Tregtisë.

Në panairin ?EXPOKOS? do të prezantohen produkte të shumëllojshme nga teknologjia e avancuar, nga prodhuesit më të njohur ndërkombëtarë të fushës së ndërtimit, energjetikës, makinerisë dhe përpunimit të drurit.

Mbyllet panairi "Expokos 2011"



## Deri kur panairet do të mbahen nëpër palestra sportive?

Panairi Expokos gjatë këtyre katër ditëve ishte në qendër të vëmendjes së të gjithë komunitetit të biznesit, ekspertëve të fushave të ndërtimtarisë, energjetikës, teknikës dhe industrisë së përpunimit të drurit, si dhe opinionit publik.

## Panair i ndërtimtarisë, energjetikës dhe industrisë së drurit

### Hapet panairi ndërkombëtar ExpoKos"

## Panairi i rritës dhe bashkimit të bizneseve

"Ky panair do të hapë perspektiva të reja për prodhuesit vendës dhe për një bashkëpunim me të gjitha vendet mike, në mënyrë që panairet tjera të pozicionin e Kosovës ta gjejnë edhe më të avancuar", tha kryetari i Kuvendit të Kosovës Jakup Krasniqi.



Hapet e panairi Expokos